



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.1968/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1968/2025, të datës 01.12.2025, të parashtruar nga ankuesja R.K. nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datë 04.06.2025, mori këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1968/2025, e datës 01.12.2025, e parashtruar nga ankuesja R.K.
- II. Mbetet në fuqi** Vendimi Nr.ref.1223/205, i datës 03.10.2025 si dhe Akti/Njoftimi përfundimtar me numër protokollit 3937, i datës 31.10.2025, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur më shpalljen e kandidatëve fitues për procedurën e pranimit me numër të referencës RN00018444.

## A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil R.K.(në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 01.12.2025, përmes postës elektronike [ankesa.kpmsheck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmsheck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.ref.1223/205, të datës 03.10.2025, të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur më refuzimin e aplikacionit në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00018444, të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për pozitën e punës *Zyrtar Administrativ*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 7629/2025, të datës 01.12.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër reference Nr.Ref.1223/2025, të datës 03.10.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Kërkesën për përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.12.2025 së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar Administrativ 2; Njoftimin për verifikim paraprak me numër protokollit Nr.3629, të datës 03.10.2025; Njoftimin përfundimtar me numër protokollit Nr.3937, i datës 31.10.2025 me numër protokollit Nr.1894, i datës 31.10.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Konkursin me numër reference RN00018444, të datës 19.08.2025; Vendimin me numër protokollit Nr.3677, të datës 08.10.2025; Akt emërimin Nr.5583, të datës 22.10.2024; Akt emërimin Nr.3037, të datës 02.06.2025; Akt emërimin me Nr.1845, të datës 10.05.2025; Akt emërimin me Nr.900/2024, të datës 01.07.2024; Akt emërimin me Nr.5369, të datës 10.10.2024; Kërkesën Nr.2977, të datës 19.08.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtarëve të Komisionit të Pranimit për kandidatët në intervistë me gojë të datës 29.10.2025; Njoftimin për intervistë të datës 27.10.2025; Aplikacionin me datë aplikimi 21.08.2025 të kandidatës G.N së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 01.09.2025 të kandidatës A.R së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 18.09.2025 të kandidatës F.G së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 15.09.2025 të kandidatit A.A së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 20.08.2025 të kandidatit A.M së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 20.08.2025 të kandidatit B.B së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 03.09.2025 të kandidatës D.F së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Testin me shkrim për pozitën Zyrtar Administrativ 2., Provat shtesë të datës 03 dhe 04 qershor 2026, të përcjell nga MPJD më kërkesë të KPMSHCK-së.*

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

### *Gjendja e fakteve*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

-Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 19.08.2025, ka shpall konkursin publik për pranim me numër reference RN00018444, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm-Arsim i Lartë, për pozitën e punës Zyrtar Administrativ 2, me klasë të pozitës Profesional 2, dhjetë (10) vende pune, i hapur për aplikim 20.08.2025 deri më datën 18.09.2025.

- Në konkursin përkatës të punësimit ka aplikuar edhe ankuesja, mirëpo, të njëjtës më Vendimin Nr.Ref.1223/2025, të datës 03.10.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka plotësuar kriteret e konkursit pasi që nuk posedon së paku (1) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për pozitën e lirë të punës.

-Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 31.10.2025, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 3973, nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë fitues për pozitën përkatëse janë shpallur: D.F. me 88.4 pikë, G.N. me 86.4 pikë, A.R. me 85 pikë, F.G. 84.2 pikë, A.A. me 83.6 pikë, A.M. me 82.2 pikë dhe B.B. me 80 pikë.

### *Prendimet ankimore*

Ankuesja pas publikimit të njoftimit përfundimtar të vlerësimit brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në KPMSHCK duke kundërshtuar ligjshmërinë e Vendimit nr.ref.1223/2025, të datës 03.10.2025, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MPJD-së, lidhur më refuzimin e aplikacionit, me pretendimin se më asnjë pjesë të shpalljes nuk specifikohet që përvoja e punës duhet të jetë pas diplomimit. Shton se lidhur me përvojën e punës ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara më konkurs. Kërkon që KPMSHCK-ja të aprovoj ankesën si të bazuar, të konstatoj mos kualifikimin e ankesës si të kundërligjshëm dhe të urdhëroj MPJD-në të rivlerësoj aplikacionin e ankueses, ashtu që, të merr parasysh përvojën e punës së dokumentuar pavarësisht faktit nëse është fituara para apo pas diplomimit.

### *Vlerësimi i Kolegjit*

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë pretendimet ankimore të ankueses si dhe veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e rekrutimit RN00018444. Andaj, në kontekst të këtij përcaktimi, Kolegji fillimisht ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit për pozitën e kontestuar dhe si rrjedhojë ka gjetur se si kriteret formale të përgjithshme formale janë vendosur: Arsimimi i kërkuar: *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Së paku 1 (një) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës. Njohje e gjuhës angleze, gjermane, frenge, italiane, greke, spanjolle apo serbo kroate e preferushme.* Gjegjësisht, sipas pikës 5 të konkursit si dokumente/dëshmi që kandidatet duhet të dorëzojnë më rastin e aplikimi janë vendosur: *Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës. ° Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; ° Kopjet e dëshmisë së punësimit(vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Përvoja e punës, e cila deklarohe sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohe*

*përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës. ° Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit. ° Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Në ndërlidhje me bazushmerinë e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

- Nenit 9 paragraf 1, ku përcaktohej se: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj*

- Nenit 39 paragrafi 7 ku përcaktohet se: 7. *Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës..”*

-Neni 40: *Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe nenin 6, paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohej se: 2. *Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që*

*provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji i Këshillit ka konstatuar së kriteret e përgjithshme formale për pozitën e kontestuar kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës, dhe se Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit Nr.433/2025, të datës 08.10.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, ka qenë në përbërjen e përcaktuar më nenin 40, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Ndërsa, lidhur më pretendimet e ankuesit për refuzim të padrejtë të aplikacionit, Kolegji ka analizuar dokumentacionin e ankueses të dorëzuar më rastin e aplikimit më datë 21.08.2025, nga dhe ka gjetur së ankuesja lidhur me kriterin e arsimit ka bashkangjitur: Diplomën me numër Nr.923/23, të datës 29.06.2023, të lëshuar nga Kolegji AAB, me të cilën dëshmohet se e njëjta ka përfunduar studimet themelore më datë 16.06.2023, në drejtimin Juridik, duke marrë titullin LLB në Juridik, ndërsa, përkitazi më kriterin e përvojës së punës ka ofruar si dëshmi: Marrëveshjen Shërbimi më Kolegjin “Heimerer”, më angazhim organizmin e aktiviteteve në terren, për periudhën 18.04.2024 deri më 19.04.2024; Kontratë mbi veprën më OJQ “Ta pastrojmë Kosovë”, të datës 10.09.2018, më angazhim në Qendrën e Thirrjeve, në kohëzgjatje 30 ditëve; Vërtetimin pa datë të lëshimit, më të cilin konfirmohet se ankuesja ka qenë e kontraktuar në Kooperativa Agency LLS më marrëveshja për shërbime të veçanta për periudhën 2021 dhe 2022 (nga vërtetimi nuk saktësohet pozita e angazhimit të ankueses dhe kohëzgjatja e angazhimit si dhe kjo përvojë nuk arsyetohet me pasqyrë të Trustit Pensional); Kontratën Nr.KM/2019 për marrëveshje të veçantë të shërbimit e lidhur me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për periudhën 06.09.2019 deri 05.02.2020, e angazhuar si staf mbështes për Inspektoriat dhe Vërtetimin e lëshuar nga biznesi “Base Agency ( pa datë të lëshimit), ku vërtetohet se e njëjta ka qenë e punësuar pranë kësaj Agjencie në periudhën Qershor dhe Gusht 2021 dhe Mars 2022. Pra, mbi gjendjen e këtyre fakteve rrjedhë së ankuesja nuk ka 1 vit përvojë punë pas diplomimit, pasi që, e njëjti ka diplomuar më datë 16.06.2023, ndërsa, përvoja e deklaruar ka të bëjë më periudhën para diplomimit.

Rrjedhimisht, Kolegji thekson faktin se përvojë pune profesionale konsiderohet vetëm përvoja pas diplomimit në studime themelore, përcaktim ky tashmë i konsoliduar më praktikën vendimmarrëse të Këshillit dhe i konfirmuar edhe nga gjykata (Aktgjykimet e Gjykatës Themelore A.nr.2276/2014 dhe A.nr.729/2016, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.367/2018, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ARJ-AZVP nr.77/2019).

Andaj, duke u nisur nga fakti se ankuesja nuk ka arritur të argumentoj se posedon përvojë një vjeçare profesionale siç kërkohej më konkursin përkatës, Kolegji konstaton se nuk kanë mbështetje pretendimet ankimore dhe si rrjedhojë Njësia e Burimeve Njerëzore të MPJD-së më rastin e refuzimit të aplikacionit të ankueses ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, duke vepruar në pajtim më dispozitat e nenit 39, paragrafi 7.1 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku parashihet se: *7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit.*

Po ashtu, Kolegji në vështrim të parimit të meritokracisë, si një nga parimet bazë për pranim në shërbim civil, ka analizuar dosjen e aplikimit të kandidateve të shpallur fitues (dokumentacionin e dorëzuar së bashku me përgjigjen në ankesë), duke konstatuar këtë gjendje faktike:

**-Kandidatja G.N.** lidhur me kriterin e arsimit posedon Diplomën me numër Nr.503/21, të datës 22.04.2021, të lëshuar nga Kolegji AAB, me të cilën dëshkohet se e njëjta ka përfunduar studimet themelore më datë 16.04.2021, në programin Gjuhë Angleze, me specializim i përgjithshëm, ndërsa, përkitazi me përvojën e punës ka bashkangjitur Kontratën e Marrëdhënies së punës të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme me numër të kontratës Nr.001/2022, të datës 04.03.2022, për themelimin e marrëdhënies së punës në pozitën Asistente Konsullore në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Slloveni, për periudhën kohore prej 07.03.2022 deri më 06.03.2023;

**-Kandidatja A.R.** lidhur me kriterin e arsimit posedon Diplomën me numër 6757, të datës 01.10.2019, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshkohet se e njëjta ka përfunduar studimet themelore më datë 23.09.2019, në Departamentin e Filozofisë, programi Filozofi; Diplomën me numër Nr.1092, të datës 04.10.2023, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshkohet se e njëjta ka përfunduar studimet master më datë 18.07.2023, në Departamentin e Shkencave Politike, në programin e Studimeve Evropiane dhe Administratë Publike. Ndërsa, lidhur me kriterin e përvojës së punës ka bashkangjitur si dëshmi Certifikatën Nr.362/2024, të datës 21.05.2024, të lëshuar nga Njësia e Personelit të MPJD-së me të cilën dëshkohet se ka qenë në punë praktikë në MPJD nga data 01.05.2023 deri 31.10.2023 dhe nga 01.11.2023 deri me 30.04.2024. Po ashtu, kandidatja posedon dëshmi për punë praktike në kompani private por për Kolegjin kjo përvojë nuk ishte relevante, pasi që në kuptim të nenit 16, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, puna praktike pas diplomimit konsiderohet përvojë pune në kohëzgjatje prej një (1) viti, dhe se kandidatja ka përvojë praktike një vjeçare në MPJD.

**-Kandidatja F.G.** lidhur me kriterin e arsimit posedon Diplomën Nr.1274, të datës 26.12.2011, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, me të cilën dëshkohet se e njëjta ka përfunduar studimet themelore më datë 15.02.2011, në Departamentin e Letërsisë Shqipe, Fakulteti i Filologjisë dhe Diplomën me numër Nr.866, të datës 29.10.2019, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshkohet se e njëjta ka përfunduar studimet master, në degën e Letërsisë Shqipe. Lidhur me kriterin e përvojës së punës posedon Vërtetimin pa datë të lëshimit nga Drejtoresha e Kopshtit të Fëmijëve RUBIKS, me të cilin vërtetohet së kandidatja në fjalë ka qenë e angazhuar në mësim plotësues për shkollaret për periudhën 01.09.2019 deri 15.06.2024. Rjedhimisht, sipas Kontratës së punës së datës 01.01.2024, del së kandidatja për periudhën 01-04.2024 deri 15.06.2024, ka ushtruar pozitën asistente pranë këtij kopshti, kurse sipas Pasqyrës së Trustit del së kandidatja ka punuar pranë këtij biznesi për periudhën shtator-dhjetor 2019, janar dhe shkurt 2020, shkurt -dhjetor 2023, janar, maj, qershor 2024.

**-Kandidati A.A.** lidhur me kriterin e arsimit posedon Diplomën Nr.26, të datës 02.05.2006, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, me të cilën dëshkohet se i njëjti ka përfunduar studimet themelore më datë 05.07.2005, në drejtimin Gjuhë dhe Letërsi Frënge, Fakulteti i Filologjisë dhe Diplomën për përfundimin e studimeve master në Universitetin e Parisit 8 MAITRIË, “Master në Shkenca Humane dhe Sociale- drejtimi Gjeopolitikë, gradë kjo e njohur përmes Vendimit të MASHTI, me numër Nr.614-4515, të datës 20.05.2013. Ndërsa, lidhur me kriterin e përvojës së punës posedon Kontratën e punës për kohë të caktuar me numër Nr.1337/05, e datës 09.10.2024, për themelimin e marrëdhënies së punës më Komunën e Pejë, ashtu që i njëjti nga data 01.10.2024 është i punësuar në Gjimnazin “Bedri Pejani”-Pejë si Mësimdhënës i Gjuhës Frënge, Kontratën e datës

25.02.2016, për themelimin e marrëdhënies së punës si Këshilltar Politik në Kabinetin e Ministrisë së Kulturës, pozitë të cilës sipas deklarimeve të ankuesit e ka ushtruar nga data 25.02.2016 deri më 04.08.2017, Vërtetimin nr.06-4831, të datës 13.05.2014, të lëshuar nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, më të cilin është konfirmuar së kandidati në fjalë ka qenë asamblist në këtë komunë më mandat 4 vjeçar, i zgjedhur në zgjedhjet 2013. Po ashtu posedon edhe dëshmi tjera lidhur me përvojën e punës por që të njëjta janë në gjuhë frënge, të pakuptueshme për Kolegjin.

**-Kandidati A.M.** lidhur me kriterin e arsimit posedon Diplomë me numër Nr.D-669/19, të datës 11.09.2019 të lëshuar nga Kolegji ISPE, me të cilën dëshkohet se i njëjti ka përfunduar studimet themelore më datë 17.07.2019, në Programin Studime të Sigurisë, duke marrë titullin Bachelor i Arteve në Studime të Sigurisë, kurse, lidhur më përvojën e punës kandidati ka ofruar si provë: Vërtetimin më numër të protokollit 592, të datës 15.05.2024, të lëshuar nga Njësia e Personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), ku vërtetohet se i njëjti ka kryer punë praktike në Departamentin e Sigurisë Juridike si përfitues i Skemës së Punësimit të garantuar për të rinjtë, Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, për periudhën kohore 08.05.2023 deri 07.05.2024. Kandidati ka bashkangjitur edhe dëshmi tjera lidhur me punë praktike në institucione private dhe publike, por që Kolegji nuk i konsideroj si relevante pasi që në kuptim të nenit 16, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, puna praktike pas diplomimit konsiderohet përvojë pune në kohëzgjatje prej një (1) viti, ndërsa ankuesi ka përvojë praktike një vjeçare në MPB.

**-Kandidatja B.B.** lidhur me arsimin ka bashkangjitur Diplomën Nr.7878, të datës 15.09.2022, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshkohet se e njëjta ka përfunduar studimet themelore më datë 18.07.2022, në Departamentin për Punë Sociale, duke marrë titullin Bachelor i Punës Sociale. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës posedon Kontratën e punës numër protokollit Nr.04.02-34/5, të datës 16.04.2024, për themelimin e marrëdhënies së punës si regjistruar aktiv në ASK, në kohëzgjatje prej 29.03.2024 deri me 25.05.2024; Marrëveshjet me numër protokollit Nr.04/24-04, e datës 29.09.2024 dhe numër protokollit Nr.163/25-04, të datës 21.03.2025, për angazhim të praktikës në punë, Skema e punësimit të garantuar të rinjë, për periudhën 23.09.2024 deri më datë 22.03.2025 dhe 24.03.2025 deri me datë 23.09.2025;

**-Kandidatja D.F.** lidhur me kriterin e arsimit posedon Diplomën nr.1451/21 të datës 17.07.2021, të lëshuar nga Kolegji AAB, më të cilin vërtetohet se e njëjta ka përfunduar studimet themelore më datë 04.07.2021, në Programin Administratë Publike, ndërsa, përkitazi, më përvojën e punës posedon Kontratën më Procredit Bank, për punë praktike më pagesë e cila sipas pasqyrës se Trustit ka qenë për periudhën korrik, gusht dhe shtor 2021; Kontratën me numër Nr.806/2021, të datës 12.10.2021, më punëdhënësin Kolegji AAB, për punë praktike në periudhën 01.10.2021 deri më datë 31.12.2021, Kontratën e punës ref.031/2022, të datës 21.01.2022, për themelimin e marrëdhënies së punës më Kolegjin AAB, në pozitën e punës Asistente Administrative, për periudhën 01.01.2022 deri më datë 30.06.2022 ( përvojën e punës pranë këtij kolegji e mbështet edhe më pasqyrë të kontributeve profesionale); Kontratat për punë praktike me pagesë në Banka TEB, punë kjo që sipas pasqyrës se Trustit ka të bëjë periudhën shtator 2002 deri korrik 2023 dhe Kontratat për themelimin e marrëdhënies së punës më institucionin financiar jo bankar “ BiCredit SHA” në pozitën e analistes kreditore, ashtu që, sipas Pasqyrës së Trustit punësimi në këtë institucion ka qenë për periudhën korrik 2023 deri dhjetor 2024.

Andaj, si pasojë e analizimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve të shpallur fitues rrjedhë se të nëntit kanë plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkursin e kontestuar, e duke qenë se kanë arritur numrin më të madh të pikëve, atëherë, më të drejtë njësia përgjegjëse, në këtë rast Divizioni i Burimeve Njerëzore në MPJD, i ka shpallur si kandidatë fitues për procedurën me numër reference RN00018444, siç përcaktohet me nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në konstatimet si me lartë, dhe duke qenë se nuk janë evidentuar shkelje ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura me numër reference RN00018444 është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

***Lënda:A.nr.1968/2025***

**Merlinda RAMAJ**

Procesmbajtëse

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, R.K;
- MPJD: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të NJBNJ, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së